



The mCham

ISSUE 94 / FEBRUARY 2019

WWW.AMCHAM.COM.AL

THE OFFICIAL MAGAZINE OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

2019

FISCAL PACKAGE

**AMCHAM MEMBERS
MEET WITH
CUSTOMS DIRECTOR
BELINDA IKONOMI**

**FOREIGN
INVESTORS
IN ALBANIA**

**AMCHAM MEETS WITH
THE DEPUTY DIRECTOR
OF TAXES XHAVIT ÇURRI**

AMCHAM BOARD



PRESIDENT
Mark C. CRAWFORD
*Aksioner International
Securities Brokerage*



VICE-PRESIDENT
Radmilo VLACIC
Philip Morris Albania



SECRETARY
Michael WALKER
Hilton Garden Inn Tirana



TREASURER
Jueta ISAJ
DDB Albania


BOARD MEMBERS



Dael DERVISHI
Optima Legal & Financial




Enio JACO
CBS Creative Business Solutions



Brandt W. HOFFMAN
G&H Partners

Për më shumë informacion në
lidhje me aktivitetet tona dhe
lajmet me të fundit na ndiqni në:
www.amcham.com.al



CONTENTS / PËRMBAJTJA

PUBLISHER:

American Chamber of
Commerce in Albania

EDITOR IN CHIEF:

Brikena Kamenica

DESIGN & LAYOUT:

Eduard Bujari

PRINTED BY:

Gent Grafik

The content of this
publication cannot be
reproduced in full or
part without the prior
written permission of
the publisher.

**© COPYRIGHT
FEBRUARY, 2019**

Rruga "Ibrahim
Rrugova", Sky Tower,
Suita 11-3
Tirana, Albania

PHONE:

+355 4 225 9779

E-MAIL:

info@amcham.com.al

WEB:

www.amcham.com.al

28

AmCham
Albania
celebrates
Thanksgiving
Day with its
members
and the US
community

AmCham
feston me
anëtarët dhe
komunitetin
Amerikan
Ditën e
Falenderimeve



40

FOREIGN
INVESTORS IN
ALBANIA

INVESTITORË TË
HUAJ NË SHQIPËRI



16

AmCham members meet
with Customs Director
Belinda Ikonimi

Anëtarët e AmCham takohen
me Drejtoren e Doganave,
znj. Belinda Ikonimi



38

MEMBER
NEWS

LAJME
ANETARESH



34

OPERATING
COMMITTEES

KOMITETET NË
VEPRIM

24

HOW TO
PROTECT
PERSONAL DATA

SI TË MBROJMË
TË DHËNAT
PERSONALE

20

AmCham meets with the
Deputy Director of the
General Directorate of
Taxes, Xhavit Çurri

Dhoma Amerikane
takohet me
Nëndrejtorin e
Drejtorisë së
Përgjithshme të
Tatimeve z. Xhavit
Çurri



26

TCN, a System
Integrator &
Infrastructure Company

TCN, një Kompani
Integritore Sistemeshe
dhe Infrastrukturate

Dhuroni dashuri, edhe kur ndodheni larg

Zgjidhni **besueshmërinë** dhe **mundësinë**
për të qëndruar më pranë.



RECETË PËR JETËN



**Rafinimi
fizik**

Cilësi e lartë, vaj i rafinuar fizikisht

Karakteristikat e vajit të rafinuar fizikisht:

vajrat bimorë të papërpunuar, përpunohen me anë të procedurave të pastra fizike (p.sh., filtrimi, centrifugimi, avullimi) i cili është një proces i butë

rafinimi fizik ruan përbërësit e vegjël të vlefshëm të vajrave bimorë, si tokoferolet (vitamina E) dhe sterolet

më efikas se rafinimi kimik, pasi rrit prodhimin e vajit të rafinuar dhe ka më pak ndikim në mjedis

Në mënyrë që vaji të arrijë parametrat e cilësisë së ngrëshme, është e domosdoshme që ta rafinojmë, që do të thotë ta purifikojmë atë. Rafinimi i vajit të papërpunuar mund të jetë kimik ose fizik. Kompania Bunge, prodhuese e Floriol në fabrikën Hungareze Martfu përdor metoda moderne të rafinimit fizik, që – nëpërmjet procesit të butë – ofrojnë një hoqe efektive të përbërësve të padëshiruar nga vaji i papërpunuar, duke ruajtur komponentët e dobishëm.



**CILËSI E
NJËJTË,
PAMJE
E RE**

Certifikatat:
ISO 14001, OHSAS 18001, IFS Food Version 6, Certifikata HALAL IIDC
www.floriol.ba





Leading distributor of ingredients and additives for the building materials industry in Albania and Kosovo

connecting industries



**Providing top quality products,
customer service, and technical support**

INFORMACION
PËR OFERTAT
NË KOHË REALE

BLINI ONLINE
SIGURACIONIN

INFORMOHUNI
MBI PROÇESIN
E TRAJTIMIT TË
DËMIT TUAJ.

Kurseni kohë dhe para.
Ndhuni të sigurt.

SIGMA **INTERALBANIAN** 
VIENNA INSURANCE GROUP


Shkarkoni aplikacionin
për celular



www.sivig.al

PATRON MEMBERS



2019 FISCAL PACKAGE



On 3rd of December 2018, the Parliament passed the so-called “2019 Fiscal Package”. The new laws are now published in the Official Gazette and entered into force on 1st January 2019, except for the law no. 95/2018 amending Law no. 9632/2006 “On Local Tax System” which will enter into force on 12th January 2019. Below you will find a summary of the most important amendments introduced by the Fiscal Package.

INCOME TAX LAW (law no. 8438/1998 “On Income Tax”)

Law no. 94/2018 “On some amendments and additions to law no. 8438/1998 “On Income Tax” (published in the Official Gazette no. 183, dated 21.12.2018), provides for the following amendments:

Items of Albanian source income

Additional income shall be included in the list of Albanian source income, becoming as such subject to taxation in Albania:

- i) income from immovable properties, their accessories and civil fruits, as well as the income deriving from the rights on immovable properties situated in the Republic of Albania;
- ii) income from exercising of rights for exploitation of minerals, hydrocarbons or other natural resources within the territorial sovereignty of the Republic of Albania;
- iii) income from alienation of property and rights stated above;
- iv) income from alienation of shares or similar interest, such as interests in partnerships or trusts, re-

gardless of the place of registration, in case, at any time during a period 365 days preceding the alienation, more than 50 per cent of the value of these shares or similar interest derives directly or indirectly from the immovable property or the rights as mentioned herein above.

- v) income generated by a non-resident person from services rendered to an Albanian tax resident (irrespective of the territory where the services are performed).

Reduction of tax on dividend

The tax on dividends and profit sharing has been reduced to 8% (from 15%). The reduced 8% rate shall also apply for dividends distributed from retained earnings generated during the year 2018 and earlier, provided that the tax on dividend deriving from the profit gen-

NEW MINIMUM NATIONAL WAGE

Upon decision dated 26 December 2018, the Council of Ministers decided to increase the minimum monthly wage to Leke 26,000 (from Leke 24,000), effective as of 1 January 2019. As a result of this decision, the amount of social contributions payable by both employee and employer will be increased. According to the current rules, the minimum amount taken into consideration for calculation of social contributions is equal to the minimum monthly wage, while the maximum amount is increased to Leke 114,670.

erated in the year 2017 and previous years is paid within 30 September 2019, while the tax on dividend from the profit generated on year 2018 is paid within 20 August 2019.

Reduction of income tax on employment related income

Under the amended provision, the tax rate of 23% shall be applied on the new limit of Leke 150,000. As a result, monthly wages from Leke 30,001 to Leke 150,000 shall be subject to a tax equal to 13% of the amount over Leke 30,000. Monthly wages from Leke 150,001 and above shall be now subject to a tax equal to the amount of Leke 15,600 plus 23% of the amount over Leke 150,000. Monthly wages up to Leke 30,000 remain exempted from tax.

New item of non-deductible expense

“Per diem expenses that exceed

It is now possible for a non-resident person to be registered for profit tax in Albania and file a profit tax return, enabling him to declare and pay tax in Albania.





“

Tashmë është e mundur që një person jo-rezident të regjistrohet për tatimin mbi fitimin në Shqipëri dhe të depozitojë një deklaratë tatimore, me qëllim që **të ketë mundësi të deklarojë dhe të paguajë tatim në Shqipëri.**

PAGA E RE MINIMALE MUJORE

Me vendimin e datës 26 dhjetor 2018, Këshilli i Ministrave rriti pagën minimale mujore ne shkallë vendi duke e bërë atë 26.000 Lekë (nga 24.000 Lekë që ishte më parë). Rritja hyn në fuqi më 1 janar 2019. Si rezultat i këtij vendimi, do të rritet shuma e kontributeve të sigurimeve shoqërore të pagueshme si nga punëmarrësit ashtu dhe nga punëdhënësit. Sipas rregullave aktuale, shuma minimale e marrë në konsideratë për llogaritjen e kontributeve shoqërore është e barabartë me pagën minimale në shkallë, ndërsa ajo maksimale rritet në shumën 114.670 Lekë.

PAKETA FISKALE 2019

Në datën 3 dhjetor 2018, Kuvendi i Shqipërisë miratoi atë që quhet “Paketa Fiskale 2019”. Ligjet e reja u publikuan në Fletoren Zyrtare dhe kanë hyrë në fuqi me 1 janar 2019, përveç ligjit nr. 95/2018 për ndryshimin e Ligjit nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i cili hyn në fuqi me 12 janar 2019.

Më poshtë është një përmbledhje e ndryshimeve më të rëndësishme të Paketës Fiskale.

LIGJI PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT (Ligji nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”)

Ligji nr. 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (botuar në Gazetën Zyrtare nr. 183, datë 21.12.2018) parashikon ndryshimet e mëposhtme:

Zëra të ardhurash me burim në Shqipëri

Disa lloje të reja të ardhurash do të përfshihen në listën e të ardhurave me burim në Shqipëri dhe si të tilla do të jenë të tatueshme në Shqipëri:

- të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë;
- të ardhurat e krijuara nga ushtrimi i të drejtave për shfrytëzimin e pasurive minerare, hidrokarbure ose

- të drejtave të tjera për shfrytëzimin e burimeve të tjera natyrore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- të ardhurat nga tjetërsimi i pasurisë dhe të drejtave të lartpërmendura;
- të ardhurat nga tjetërsimi i aksioneve ose interesave të ngjashme, siç janë interesat në ortakëri ose truste, pavarësisht nga vendi i regjistrimit, në rast se në çdo kohë gjatë një periudhe 365 ditë para tjetërsimit, më shumë se 50% e vlerës së këtyre aksioneve ose interesave të ngjashme rrjedhin drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga pasuria e paluajtshme ose të drejtat e përmendura më lart.
- të ardhurat që përfitohen nga një person jo-rezident me anë të shërbimeve të kryera kundrejt një personi rezident (pavarësisht vendit ku ofrohet shërbimi).

Reduktimi i tatimit mbi dividendët

Tatimi mbi dividendët dhe ndarjen e fitimit është reduktuar në 8% (nga 15%). Norma e reduktuar prej 8% do të zbatohet edhe për dividendët e shpërndarë nga fitimet e realizuara gjatë vitit 2018 dhe më herët, me kusht që tatimi mbi dividendin që rrjedh nga fitimi i realizuar në vitin 2017 dhe vitet e mëparshme të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa taksa mbi dividendin nga fitimi i realizuar në vitin 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019.



50% of the amount of annual gross wages' expenditure of the taxpayer" is added to the list of non-deductible expenses for profit tax purposes.

Registration of a non-resident for profit tax purposes

It is now possible for a non-resident person to be registered for profit tax in Albania and file a profit tax return, enabling him to declare and pay tax in Albania. A forthcoming instruction of the Minister of Finance will determine the form and content of the said tax return. The tax return shall be filed by 31st of March of next year. The tax is due by the same date.

The non-resident person shall not be required to make any tax prepayments and it is not permitted to any foreign tax credits.

Taxation of capital gains

a) Legal entities whose ownership changes by more than 20%

Capital gains become taxable when the following conditions are met:

- there is a change of ownership of the share capital or voting rights held in a legal entity, either directly or indirectly, by more than 20%; and
- such legal entity has generated an average annual turnover in the previous three years of Leke 500 million.

Taxation of capital gains under such conditions is applicable irrespective of whether the shares' value derives directly or indirectly from immovable property or rights of exploiting natural resources situated in Albania, or not.

The legal entity must submit a written notification to tax authorities within 45 days from the transfer of ownership.

Payment of the capital gain tax is performed by the legal entity, which for this purpose is deemed to have sold a proportional part (equal to the amount of transfer of ownership in shares or voting rights) of all its assets immediately before the transfer. Such legal entity shall be considered as beneficiary of the income from sale of assets (proportionally with the market value of the assets), and as buyer of those assets at the same value.

When the tax on capital gain is paid by the legal entity as per the above rules, the shareholder or holder of voting rights subject to transfer, is exempted from profit tax in Albania.

Failure to comply with the above procedures is subject to a fine equal to 15% of the market value of the assets deemed as transferred.

b) Taxation of capital gains occurring from change of ownership by more than 10% of shares, whose value derives from immovable property situated in Albania

Under the new provisions, a notification is to be made in case of change of ownership of the share capital of a legal entity, either directly or indirectly, by more than 10%, provided that more

than 50 per cent of the value of such shares, at any time for 365 days preceding the transfer, derives directly or indirectly from the immovable property, or the rights of exploitation of natural resources, which are situated in Albania. The legal entity must submit the notification to the tax authorities within 45 days from the said transfer.

The tax on capital gains in such cases shall be declared and paid by the transferor, by filing a profit tax return as a non-resident person.

Failure to comply with the above procedures is subject to a fine equal to 5% of the market value of the shares/similar interest transferred.

EXCISE TAX LAW (law no. 61/2012 "On Excise Tax")

Excise Tax Law is amended by law no. 98/2018 "On some amendments and additions to law no. 61/2012 "On Excise Tax" by introducing the excise tax for the following goods:

- bituminous gravel at the rate of 0.3 Leke/kg;
- heated tobacco at the rate of 6,000 Leke/kg.

The excise tax for energy drinks (previously at the rate of Leke 30/liter) has been removed.

The amendments provide also for the increase of the excise tax rate to 6,000 Leke/kg for cigars and cigarillos that contain tobacco or tobacco substitutes (except if manufactured with tobacco cultivated in Albania). Excise tax for cigarettes has been increased to 6,000 Leke per 1,000 pieces.

In addition, penalties applicable in case of breaches to the Excise Tax Law have undergone some amendments.

TAX PROCEDURES LAW (Law no. 9920/2008 "On Tax Procedures")

Law no. 97/2018 amended law no. 9920/2008 "On Tax Procedures", by providing the following:

A unique business registration number for each taxpayer


The new provisions clarify that entrepreneurs registered with the Commercial Register as sole entrepreneurs ("person fizik tregtar") may obtain only one (unique) business registration number. If such person conducts

“

A forthcoming instruction of the Minister of Finance will determine the form and content of the said tax return.

The tax return shall be filed by 31st of March of next year.

The tax is due by the same date.



Reduktimi i tatimit mbi të ardhurat nga punësimi

Sipas dispozitës së ndryshuar, norma e tatimit prej 23% zbatohet në kufirin e ri prej 150.000 lekë. Si rezultat i këtij ndryshimi, pagat mujore nga 30.001 lekë deri në 150.000 lekë do t'i nënshtrohen një tatimi të barabartë me 13% të shumës mbi 30.000 lekë. Pagat mujore nga 150.001 lekë e lart do t'i nënshtrohen një tatimi të barabartë me shumën prej 15.600 lekë plus 23% të shumës mbi 150.000 lekë. Pagat mujore deri në 30.000 lekë mbeten të përjashtuara nga tatimi.

Një element i ri në shpenzimet e pazbritshme

"Shpenzimet për dieta që tejkalojnë 50% të fondit të pagës bruto vjetore të tatimpaguesit" shtohen në listën e shpenzimeve të pazbritshme për qëllime të tatimit mbi fitimin.

Regjistrimi i një jo-rezidenti për qëllime të tatimit mbi fitimin

Tashmë është e mundur që një person jo-rezident të regjistrohet për tatimin mbi fitimin në Shqipëri dhe të depozitojë një deklaratë tatimore, me qëllim që të ketë mundësi të deklarojë dhe të paguajë tatim në Shqipëri. Një udhëzim i ri i Ministrit të Financave do të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e deklaratës tatimore në fjalë. Deklarata tatimore duhet të dorëzohet deri më 31 mars të vitit pasardhës. Pagesa e taksës duhet të bëhet brenda të njëjtës datë.

Personit jo-rezident nuk do t'i kërkohet të bëjë ndonjë parapagim tatimor dhe nuk do t'i lejohet kreditim për tatime të paguara në vende të huaja.

Tatimi i fitimeve të kapitalit

Personat juridikë pronësia e të cilëve ndryshon me më shumë se 20%. Fitimet e kapitalit bëhen të tatueshme kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- » ka ndryshim të pronësisë së kapitalit të aksioneve ose të të drejtave të votimit të një personi juridik, direkt ose indirekt me më shumë se 20%;
- » dhe ky subjekt juridik ka një qarkullim vjetor mesatar në tre vitet e mëparshme prej 500 milionë lekë.

Tatimi i fitimeve të kapitalit në kushte të tilla është i zbatueshëm pa varësisht nëse vlera e aksioneve rrjedh drejtpërdrejt ose tërthorazi nga prona e paluajtshme ose të drejtat e shfrytëzimit të burimeve natyrore të vendosura në Shqipëri, apo jo. Personi juridik duhet të dorëzojë një njoftim me shkrim tek autoritetet tatimore brenda 45 ditëve nga transferimi i pronësisë. Pagesa e tatimit mbi fitimin e kapitalit kryhet nga personi juridik, i cili për këtë qëllim konsiderohet si të jetë duke shitur një pjesë proporcionale të të gjitha pasurive të tij menjëherë përpara ndryshimit. Personi juridik trajtohet si:

a) përfitues i të ardhurave nga shitja, e barabartë kjo me pjesën proporcionale të vlerës së tregut të aktivitetit në atë

66

Një udhëzim i ri i Ministrit të Financave do të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e deklaratës tatimore në fjalë. **Deklarata tatimore duhet të dorëzohet deri më 31 mars të vitit pasardhës.** Pagesa e taksës duhet të bëhet brenda të njëjtës datë.



kohë; dhe

b) riblerës i aktivitetit për të njëjtën vlerë.

Kur tatimi mbi fitimin e kapitalit paguhet nga personi juridik sipas rregullave të mësipërme, aksioneri ose zotëruesi i të drejtave të votimit që i nënshtrohen transferimit, përjashtohen nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri.

Mosrespektimi i procedurave të mësipërme i nënshtrohet një gjobe të barabartë me 15% të vlerës së tregut të aktiveve që konsiderohen të transferuara. Tatimi i fitimeve të kapitalit që rrjedhin nga ndryshimi i pronësisë me më shumë se 10% të aksioneve, vlera e të cilave rrjedh nga pasuri të paluajtshme që ndodhen në Shqipëri. Sipas dispozitave të reja, duhet të bëhet njoftim në rast të ndryshimit të pronësisë së kapitalit të një personi juridik, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me më

shumë se 10%, me kusht që më shumë se 50% e vlerës së këtyre aksioneve, në çdo kohë për 365 ditë para transferimit, të rrjedhin direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme ose të drejtat për shfrytëzimin e burimeve natyrore të cilat ndodhen në Shqipëri. Personi juridik duhet të dorëzojë njoftimin tek autoritetet tatimore brenda 45 ditëve nga transferimi në fjalë. Tatimi mbi fitimet e kapitalit në raste të tilla do të deklarohet dhe paguhet nga transferuesi, duke paraqitur një deklaratë tatimore për fitimin si një person jo-rezident. Mosrespektimi i procedurave të mësipërme i nënshtrohet një gjobe të barabartë me 5% të vlerës së tregut të aksioneve/interesit të ngjashëm të transferuar.

LIGJI PËR AKCIZAT (Ligji nr. 61/2012 "Për akcizat")

Ligji për Akcizat ndryshohet me ligjin nr. 98/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012 "Për akcizën" dhe parashikon aplikimin e taksës së akcizës për mallrat në vijim:

- » zhavorr bituminoz në masën 0,3 Lekë/kg;
- » duhani me ngrohje në masën 6.000 Lekë/kg.

Akciza për pijet energjike (që më më parë ishte në masën 30 lekë/litrë) është hequr. Ndryshimet parashikojnë gjithashtu rritjen e masës së akcizës në 6.000 lekë/kg për puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan ose zëvendësues të duhanit (përveç rasteve kur prodhohen me duhan të kultivuar në Shqipëri). Taksa e akcizës për cigare është rritur në 6.000 lekë për 1.000 fije. Gjithashtu, dënimet e zbatueshme në rast të shkeljeve të Ligjit mbi Akcizën kanë pësuar disa ndryshime.

LIGJI PËR PROCEDURAT TATIMORE

(Ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore")

Ligji nr. 97/2018 ndryshoi Ligjin nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore" si më poshtë:

Një numër unik i regjistrimit të biznesit për secilin tatimpagues

Dispozitat e reja sqarojnë se sipër-marrësit e regjistruar në Regjistrin Tregtar si *persona fizikë tregtare* mund të marrin vetëm një numër (unik) të regjistrimit të biznesit. Nëse një person i tillë kryen biznes në më shumë se një vend, Regjistri Tregtar i lëshon këtij personi certifikatën e regjistrimit të biznesit për adresat dytësore me të njëjtin numër biznesi.

Pezullimi i aktivitetit të biznesit

Në rast të aplikimit në Regjistrin Tregtar për pezullimin e veprimtarisë (tatimpaguesit pa aktivitet që transferohen në status pasiv), Regjistri Tregtar do të pranojë kërkesën vetëm nëse aplikanti nuk ka detyrime tatimore të paguara. Nëse ekziston ndonjë detyrim tatimor, aplikimi refuzohet.





business in more than one location, the Commercial Register will issue to this person a business registration certificate for the secondary addresses with the same business number.

Suspension of business activity

In case of application with the Commercial Register for suspension of activity (dormant taxpayers transferred into passive status), the Register will accept the application only if the applicant has no outstanding tax obligations. If there is any existing obligation, the application is rejected.

Penalties for supplies to and from dormant taxpayers (in passive status)

The amended law imposes specific penalties for the taxpayers who enter into transactions with dormant taxpayers. Both the seller and the buyer are subject to penalties. However, in cases when the buyer is a dormant taxpayer, no penalty shall be imposed if the list of dormant taxpayers is not duly updated by the tax authorities.

De-registration of taxpayers

The new law determines new rules for the procedure of de-registration of taxpayers from the Commercial Register and tax authorities aiming to simplify the procedures and to reduce the time needed to finalize the de-registration process.

Penalties for incorrect declaration

Currently, reassessment of a tax credit balance is not subject to any penalty. According to the amendment, in case the credit balance is reduced following a tax audit, a penalty equal to 20% of the reduced amount shall apply.

General anti-abuse rule

One of the most important changes is the introduction of the "general anti-abuse rule".

According to the new provisions, the tax authorities shall disregard an arrangement or a series of arrangements which:

The amended law imposes specific penalties for the taxpayers who enter into transactions with dormant taxpayers. Both the seller and the buyer are subject to penalties.

- i) is/are made to circumvent the principles of tax laws;
- ii) does/do not reflect the economic reality;
- iii) is/are not genuine having regard to all relevant facts and circumstances;
- iv) is/are not made for valid commercial reasons;
- v) is/are made to obtain a tax advantage.

Tax authorities may use alternative assessment methods to recharacterize the transaction and assess the tax obligation. The tax authorities have the burden of proof that the arrangement is abusive.

No payment of interest as a condition for filing a tax appeal

The new law abrogates the payment of interest as a condition for filing a tax appeal. As a result, taxpayers shall be required to prepay only the amount of principal, before the commencement of the appeal process.

VALUE ADDED TAX (Law no. 92/2014 "On Value Added Tax")

The law no. 96/2018 "On some amendments and additions on the law no. 92/2014 "On Value Added Tax" introduced a reduced Value Added Tax rate for the following supplies:

- provision of advertising services from audiovisual media is reduced

to 6%;

- supply of electric buses for public transport is reduced to 6% until 31.12.2021, and thereafter it will be increased to 10%;
- supply of books of any type is reduced to 6%.

The list of VAT exempt supplies is also extended to cover:

- the supply of agricultural machineries (*the list of machineries is to be defined by a decision of the Council of Ministers*);
- the supply of agriculture's inputs like seeds, fertilizers, agrochemicals (except hormones classified under nomenclature code 2937). Same as above, the list of categories will be defined by a decision of the Council of Ministers;
- the supply of veterinary services, except from veterinary services to pets;
- the supply of services by subcontractors of contractors engaged in the inward processing regime (*the service of processing of non-Albanian goods for re-exportation*), and
- the import of raw materials used for the production of drugs from authorized pharmaceutical production factories (*the list of materials is to be defined by decision of the Council of Ministers*).

NATIONAL TAXES (Law no. 9975/2008 "On National Taxes")

Changes have been introduced also to the national tax systems (*upon law no. 93/2018*). It is worth mentioning that the tax on plastic packaging will be substituted with a tax on plastic materials (*levied upon certain goods as set out in the law*). In addition, the royalty tax on chromium is increased at 7% for the year 2019, 8% for the year 2020 and 9% in the following years. The royalty tax payable for local supplies of metallic minerals shall be lower than the royalty tax payable in case the same minerals are exported.

LOCAL TAXES (Law no. 9632/2006 "On Local Tax System")

Law no. 95/2018 amending Law no. 9632/2006 "On Local Tax System" intends to clarify the application of the tax on infrastructure from new constructions and the advertisement/billboard tax. In addition, under the amending law, the tax on infrastructure from new constructions is reduced and becomes subject to 0% up to 3% of the investment value for new residential buildings in the mountain regions (*the boundaries of the specific region to be defined by the respective municipality council*). The new law will become effective 15 days after publication in the Official Gazette (*i.e. 12 January 2019*).



Ndeshkimet për transaksione kundrejt dhe nga taksapagues pa aktivitet (në status pasiv)

Ligji i ndryshuar vendos gjoba të veçanta për tatimpaguesit që hyjnë në transaksione me tatimpaguesit në status pasiv. Si shitësi ashtu dhe blerësi janë subjekt i gjobave. Megjithatë, në rastet kur blerësi është një tatimpagues pa aktivitet, gjoba nuk do të vendoset nëse lista e tatimpaguesve me status pasiv nuk përditësohet si duhet nga autoritetet tatimore.

Çregjistrimi i tatimpaguesve

Ligji i ri përcakton rregulla të reja për procedurën e çregjistrimit të tatimpaguesve nga Regjistri Tregtar dhe organet tatimore me qëllim thjeshtësimin e procedurave dhe zvogëlimin e kohës së nevojshme për të finalizuar procesin e çregjistrimit.

Ndeshkimet për deklarim të pasaktë

Aktualisht, rivlerësimi i një teprice kreditore tatimore nuk i nënshtrohet ndonjë penalteti. Sipas dispozitave të ndryshuara, në rast se balanca e kredisë zvogëlohet pas një kontrolli tatimor, do të aplikohet një gjobë e barabartë me 20% të shumës së zvogëluar.

E drejta për rikarakterizimin e transaksioneve

Një nga ndryshimet më të rëndësishme është futja e një rregulli të përgjithshëm kundër abuzimeve me legjislacionin tatimor. Sipas dispozitave të reja, autoritetet tatimore nuk do të marrin parasysh një veprim/transaksion ose një sërë veprimesh/transaksionesh që:

- » deformojnë parimet e ligjit tatimor;
 - » nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;
 - » janë pa efekte ekonomike thelbësore;
 - » forma e veprimit/transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;
 - » evidentohen elemente të veprimeve/transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.
- Autoritetet tatimore mund të përdorin metoda alternative të vlerësimit për të ri-karakterizuar transaksionin dhe për të vlerësuar detyrimin tatimor. Autoritetet tatimore kanë barrën e provës se veprimi është abuziv.

Jo pagesë kamatëvonese si kusht për paraqitjen e një apelimi tatimor

Ligji i ri shfuqizon pagesën e kamatëvoneseve si kusht për paraqitjen e një apelimi tatimor. Si rezultat, tatimpaguesit duhet të parapagujnë vetëm shumën e principalit të tatimit përpara fillimit të procesit të apelimit.

TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR (Ligji Nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar")

Ligji nr. 96/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014



Ligji i ndryshuar vendos gjoba të veçanta për tatimpaguesit që hyjnë në transaksione me tatimpaguesit në status pasiv. **Si shitësi ashtu dhe blerësi janë subjekt i gjobave.**

"Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" solli një normë të reduktuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për furnizimet e mëposhtme:

- » ofrimi i shërbimeve të reklamave nga mediat audiovizive reduktohet në 6%;
- » furnizimi me autobusë elektrikë për transportin publik është reduktuar në 6% deri më 31.12.2021, dhe më pas do të rritet në 10%;
- » furnizimi me libra të çdo lloji reduktohet në 6%.
- » Lista e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja zgjerohet gjithashtu për të përfshirë:
- » furnizimi me makineri bujqësore (lista e makinerive do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave);
- » furnizimi me inpute bujqësore si fara, plehra kimikë, pesticide (përveç hormoneve të klasifikuara nën kodin e nomenklaturës 2937). Sikurse më lart, lista e kategorive do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;
- » shërbime veterinarë, me përjashtim të shërbimeve veterinarë për kafshët shtëpiake;
- » shërbime nga nënkontraktorët e kontraktuesit të angazhuar në regjimin e përpunimit aktiv (shërbim i përpunimit të mallrave jo-shqiptare

për rieksporim); dhe

- » importi i lëndëve të para të përdorura për prodhimin e barnave nga fabrikat e autorizuar të prodhimit farmaceutik (lista e materialeve do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave).

TAKSAT KOMBËTARE (Ligji Nr. 9975/2008 "Për Taksat Kombëtare")

Janë bërë ndryshime edhe në sistemin e taksave kombëtare (me Ligjin nr. 93/2018).

Vlen të përmendet se taksa mbi ambalazhet e plastikës do të zëvendësohet me një taksë për materialet plastike (të vendosur mbi mallra të caktuara siç parashikohet në ligj).

Gjithashtu, rritet taksa e rentës minerare për kromin në 7% për vitin 2019, 8% për vitin 2020 dhe 9% për vitet në vijim. Renta minerare që paguhet për furnizimet brenda vendit të mineraleve metalikë do të jetë më e ulët sesa renta e pagueshme në rast se këto minerale eksportohen.

TAKSAT VENDORE (Ligji nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore")

Ligji nr. 95/2018 për ndryshimin e Ligjit nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore" ka për qëllim të qartësojë aplikimin e taksës mbi infrastrukturën për ndërtimet e reja dhe taksën e tabelës.

Gjithashtu, sipas ligjit të ndryshuar, taksa e ndikimit në infrastrukturë për banesat e reja në zonat malore reduktohet dhe bëhet 0% deri në 3% të vlerës së investimit (kufijtë e zonave specifike do të përcaktohen nga këshilli bashkiak përkatës).

Ligji i ri hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare (më 12 janar 2019).



AmCham members meet with Customs Director Belinda Ikonomi

The American Chamber of Commerce in Albania began its 2019 activities with the traditional start-of-year meeting with the Customs Directorate, giving AmCham members an opportunity to have a discussion with representatives of this important institution. In her remarks about the chamber's close cooperation relationship with the Customs Directorate, AmCham Treasurer Juella Isaj said roundtables like the latest meeting are the best form of cooperation AmCham can create for its members.

AmCham members discussed issues related to the simplification of business procedures. During the discussions, Tax and Custom Committee Chair Alketa Uruçi brought to attention some of the main issues businesses face when passing through the customs system.

In her remarks, Customs General Director Belinda Ikonomi said the institution she leads has worked hard to unify the customs valuation methodology and one of the benefits businesses will enjoy is the blue valuation lane as well the green one. A lot of work is going into clearly defining the criteria to be used for businesses that will benefit from getting the blue status, ranging is use from 15.8 percent of transactions to 30 percent. The methodology has been implemented since 2018 and its use will intensify this year.

Responding to issues raised by

AmChem members, Ms. Ikonomi said the new Customs Code clearly states when reference prices are applied and price databases have been used for transactions of goods that have taken place in the last six months. This is done to take into account the lowest and highest value declared for a commodity. According to statistics of the Customs Directorate, the use of reference prices has been lowered in 2018 from 19 percent to 11.8 percent.

AmCham members also spoke about their experiences with customs clearances and relations with the customs administration.

*During the discussions, Tax and Custom Committee Chair Alketa Uruçi brought to attention some of the **main issues businesses face when passing through the customs system.***





Anëtarët e AmCham takohen me Drejtoreshen e Doganave, znj. Belinda Ikonomi

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka startuar aktivitetet për 2019-ën me takimin tradicional të fillim vitit me Drejtorinë e Doganave, duke i dhënë mundësinë bizneseve të saj anëtare të zhvillojnë formën e dialogut me këtë institucion të rëndësishëm. Duke folur për marrëdhënien e ngushtë të bashkëpunimit me këtë institucion, Përgjegjësjë e Thesarit në AmCham, znj. Juella Isaj, u shpreh se tryeza të tilla të rrumbullakëta, janë forma më e mirë e bashkëpunimit që Dhoma Amerikane mund të krijojë për anëtarët e saj.

Anëtarët e Dhomës Amerikane kanë sjellë problematika që kanë të bëjnë me thjeshtimin e procedurave të biznesit. Gjatë prezantimit të tyre, Kryetarja e Komitetit të Taksave dhe Doganave, znj. Alketa Uruçi, ka sjellë në vëmendje disa nga çështjet kryesore me të cilat përballlet biznesi kur kalon nëpërmjet sistemit doganor.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, znj. Belinda Ikonomi, përmendi në fjalën e saj se është punuar shumë për të unifikuar metodologjinë e vlerësimit doganor dhe një nga benefitet për bi-

zneset do të jetë kanali blu i vlerësimit dhe kanali jeshil. Po punohet shumë për të përcaktuar qartë kriteret mbi të cilat bizneset do ta përfitojnë këtë status, duke shkuar nga 15.8 për qind e transaksioneve në 30 për qind. Kjo metodologji është implementuar që në 2018-ën dhe do të intensifikohet gjatë këtij viti.

Znj. Ikonomi i është përgjigjur çështjeve të ngritura, duke deklaruar se Kodi i Ri i Doganave e parashikon qartë se kur aplikohet çmimi i referencës dhe janë ngritur data-

“

Gjatë prezantimit të tyre, Kryetarja e Komitetit të Taksave dhe Doganave, znj. Alketa Uruçi, ka sjellë në vëmendje disa nga çështjet kryesore me të cilat përballlet biznesi kur kalon nëpërmjet sistemit doganor.

baza me çmimet që janë përdorur për të njëjtin mall në transaksionet e gjashtë muajve të fundit. Kjo bëhet për të patur në konsideratë vlerën më të ulët dhe më të lartë me të cilin është zhdoganuar një mall. Sipas statistikave të kësaj drejtorie, niveli i aplikimeve të çmimeve të referencës është ulur gjatë 2018-ës nga 19 për qind në 11.8 për qind.

Anëtarët e AmCham-it kanë folur për përvojat e tyre gjatë zhdoganimit dhe marrëdhëniet me administratën doganore.



Issues discussed at meeting with Customs Directorate

CUSTOMS VALUE:

The recently-published Minister of Finance Instruction (MFI) Nr. 3, dated Jan. 23, 2018, "On the evaluation of goods for customs purposes", shows that the approach to reference prices has changed very little. The new guideline is based on the same lines as MFI Nr. 25, dated Nov. 30, 2007, "On procedures for the examination of the customs value".

For example, the Instruction notes that the apparent difference between the stated value and the reference prices is considered as a risk indicator, which in effect generally causes the application of reference prices. The Customs Code, on the other hand, sets out other criteria for refusing to accept the declared value of the transaction.

CUSTOMS SIMPLIFICATIONS: With the entry into force of the Union Customs Code (Reg. EU Nr. 952/2013) in the European Union, "local clearance" has become the "entry in the declarer's records" procedure. As of May 1, 2016, no new applications for local clearance have been accepted in the EU, while existing authorizations must be re-evaluated by May 1, 2019, due to the change of legislation.

THE AMENDMENT OF A CUSTOMS DECLARATION: The Customs Code provides that the declarer may change the customs declaration up to three years after the release of the goods. Point c) of Article 160 of the Code notes that *the procedural rules for amending the customs declaration after the release of the goods are defined in the by-laws for the implementation of the Code*, while the by-laws (Decision of Council of Ministers 651) do not contain such a definition.

ORIGIN OF GOODS: Customs authorities often carry out the procedures for verifying the authenticity and validity of the EUR.1 certificates of preferential origin issued by the cus-



toms authorities of the countries with which Albania has signed free trade agreements.

In general, the replies of the counterpart customs authorities confirm the authenticity of the certificates of origin, but in some cases it is confirmed that the goods do not meet the conditions for obtaining preferential tariff treatment. In these cases, the Albanian customs authorities not only declare the Albanian importing company as a debtor but also penalize it. This practice of the customs authorities is inconsistent with the Customs Code, since Albanian companies are penalized for a document the companies did not issue, and was in fact issued by the customs authorities of a country with which Albania has signed a free trade agreement.

APPEALING OF DECISIONS:

Point 2 of Article 282 of the Customs Code provides that the appeal to the Customs Directorate will be subject to the payment of all what is owed as well as a fine guarantee. Point 5 of the same Article provides that if the appeal complaint is not accepted, the General Directorate of Customs will transfer the guarantee to its account.

SANCTIONS: Article 736 of Decision of Council of Ministers (DCM) Nr. 651 for customs-related violations committed before the entry into force of the new Customs Code, but that are found out after that time, provides that the sanctions are applied according to the applicable law at the time when the violation took place. Meanwhile, the sanctions of the new Customs Code are more favorable (one time the amount owed) compared to the old Customs

Code (three times the amount owed). This provision contradicts the legal principle of applying the most favorable law as far as the amount of applicable penalty is concerned.

TEMPORARY ADMISSION REGIME:

Article 224 of the Customs Code provides that the maximum time limit during which the goods may remain under the temporary importation procedure for the same purpose and under the responsibility of the same authorization holder shall be 24 months. Whereas in special circumstances (Article 3), the customs authorities may extend the time limit for a reasonable period of time, based on a justified application by the holder of the authorization, if the authorized use can not be achieved within the time limit determined -- up to a maximum of 10 years.

LIST OF MACHINERY EXEMPTED FROM VAT ON IMPORT:

